

VENDIM
Nr.46, datë 31.8.2005

PËR VENDOSJEN E GJOBËS NDAJ SHOQËRISË “SARMIER” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 64, pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.8.2005, pasi konstatoi se shoqëria “Sarmier” sh.p.k. nuk ka paraqitur raportin ekonomiko- financiar për vitin 2004,

VENDOSI:

1. Të dënojë me gjobë shoqërinë “Sarmier” sh.p.k. me shumën prej 150 000 (njëqind e pesëdhjetë mijë) lekësh.
 2. Ngarkohet Departamenti i Administrimit, Financës dhe Burimeve Njerëzore, si dhe Departamenti i Licencave dhe Monitorimit për ndjekjen e ekzekutimit të këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema